VENDIM
Nr.214, datë 18.4.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.703, DATË 11.10.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË SHITJES SË TROJEVE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE APO TË OBJEKTEVE TË VEÇUARA, QË U NËNSHTROHEN PRIVATIZIMIT OSE TRANSFORMIMIT TË TYRE NË SHOQËRI TREGTRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.703, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në kapitullin IV të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i dytë, i shkronjës "a" të pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Vërtetimin se subjekti kërkues e ka paguar qiranë e truallit deri në çastin e pagesës së vlerës së plotë të truallit, sipas autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave.".

b) Në fund të pikës 5 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike kryeson komisionin e verifikimit të sipërfaqeve të truallit të objekteve të privatizuara, që kërkojnë saktësim.".

2. Në kapitullin e V "Të përgjithshme", pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Të gjitha dosjet me kërkesa për vlerësim trualli të objekteve të privatizuara, të dërguara nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe, pranë organeve të qeverisjes vendore, sipas vendimit nr.169, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave, për të cilat nuk është dërguar vlerësimi i truallit në ish-Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, degët e saj në rrethe dhe Ministrinë e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, deri një ditë para hyrjes në fuqi të vendimit nr.703, datë 11.10.2006, do të kthehen në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, për të filluar procedurat nga e para, sipas kërkesave të këtij vendimi.".

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Fnancave për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha